



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:250/26, Datë: 27.02.2026

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregullores (AKA) nr. 02/2025 për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 146 të mbajtur më 23.02.2026, mori:

V E N D I M

- I.** Nuk riakreditohet Kolegji Riinvest në nivel institucional.
- II.** Ndalohej regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit që kanë akreditim valid në Kolegjin Riinvest për vitin akademik 2026/2027 deri në përfundimin e procesit të ri (të dytë) të akreditimit.
- III.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M I

Kolegji Riinvest ka parashtruar kërkesë me Nr.prot.956/25, datë 31.07.2025, në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (në tekstin e mëtejme AKA) për riakreditim në nivel institucional.

AKA me datë 24.12.2025 ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Riinvest me qëllim të vlerësimit në nivel institucional.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr. 03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertëve ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit duke konstatuar se nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit, Kolegji Riinvest është vlerësuar se:

- Plotësisht, nuk e përmbushë asnjë prej fushave të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht, përmbushë një (1) nga fushat e standardeve të akreditimit;
- Pjesërisht, përmbushë pesë (5) nga fushat e standardeve të akreditimit;
- Nuk i plotëson standardet, pesë (5) nga fushat e standardeve të akreditimit;

Raporti final i Ekipit të Vlerësuesve të jashtëm konstaton se : *Sipas manualit të Akreditimit të AKA-së, për t'u dhënë një vendim pozitiv për akreditim institucional, çdo ofrues arsimor duhet të demonstrojë të paktën një nivel të konsiderueshëm përputhshmërie në gjykimin e përgjithshëm. Prandaj, dështimi në përmbushjen e të paktën një niveli të përgjithshëm të përputhshmërisë së konsiderueshme nënkupton mohimin e akreditimit. Kolegji RIINVEST demonstroi një pajtueshmëri të përgjithshme të konsiderueshme (5 herë jo në përputhje, 5 herë pjesërisht në përputhje dhe 1 herë në përputhje të konsiderueshme). Aktualisht nuk ka akreditim institucional.*

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 146 të mbajtur më 23.02.2026 ka shqyrtuar kërkesën e Kolegjit Riinvest për riakreditim dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, dispozitat ligjore dhe kompetencat, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi ju dërgohet :

- Kolegjit Riinvest;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë